



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:178159

Datë: 15.07.2021

Numri i dokumentit: 02000603

PKR.nr.1026/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Avni Sylja, me Bashkëpuntorën Profesionale Bleta Gashi Rrusta, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.S. nga Fshati . komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.5476/2017 të datës 05.02.2018, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 09.07.2021, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurorit të Shtetit Hivzi Bajraktari dhe të akuzuarit I.S., me datë 12.07.2021 mori dhe shpalli dhe me datë 15.07.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I.S., i biri i H. dhe nënës S. e gjinisë M., i lindur me datë ... në fshatin R. rruga “” nr., komuna e Prishtinës, ku edhe ka vendbanimin, i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Me datë 06.07.2017, rreth orës 23:15 në rrugën - shtëpinë e tij në fshatin ., i pandehuri pas mosmarrëveshjes që kishte me të dëmtuarin - djalin e tij A.S., me dashje që ti shkaktojë lëndim, e kishte goditur me gyp uji në trup dhe e kishte kërcënuar me fjalën “Do të mbys nëse lajmëron rastin në polici”, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.**

II. Me datë 06.07.2017, rreth orës 23:15 në shtëpinë e tij në fshatin ., i pandehuri I.S. ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armë të cilat, pas kontrollit nga Policia e Kosovës i janë konfiskuar një Pushkë M/48.kalibër numër serik 2F5687 prodhim spanjoll, katër fishek me numër serik 2F-5687, 4 copë fishek kalibri nuk i dihet, 5 fishek kalibër të ndryshëm, një karikator i zbrazët, një shufër metalike.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform dispozitave të cituara më lartë dhe neneve 7, 17, 21, 41, 46, 49, 50, 51 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarin I.S.:

I. Për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, me Dënim me Kusht duke i vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, me Dënim me Gjobë në shumë prej 350€ (treqind e pesëdhjetë euro), të cilin dënim mund ta paguajë me dy këste mujore, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundet ta paguajë gjobën, gjykata konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së, do të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që për një ditë burgim do t'i llogaritet me 20 € (njëzetë Euro) gjobë.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë)€, si dhe në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në mbështetje të nenit 282 par 1 dhe 2 të KPPK-së, dhe nenit 374 par.3 të KPRK-së, urdhërohet konfiskimi i përhershëm i sendeve - armëve: Një Pushkë M/48. kalibër numër serik 2F5687 prodhim spanjoll, katër fishek me numër serik 2F-5687, 4 copë fishek kalibri nuk dihet, 5 fishek kalibër të ndryshëm, një karikator i zbrazët, një shufër metalike.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet – arma të theksuara më lartë duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë e Themelore në Prishtinë, pasi të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

Pala e dëmtuar – i dëmtuari A.S. me vendbanim në fshatin . komuna e Prishtinës, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.5476/2017 të datës 05.02.2018, me të cilën ka akuzuar të pandehurin I.S., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 09.07.2021 ku pas leximit të Aktakuzës nga Prokurori i Shtetit dhe pasi që i akuzuari I.S. është njoftuar me të drejtat

e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, po ashtu është njoftuar për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, i njëjti është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale si në pikën 1 dhe 2 të dispozitivit të Aktakuzës, duke shtuar se sa i përket veprës penale në pikën 1 të aktakuzës, të njëjtën e ka kryer pas një mllefi që e kishte me djalin e tij, me arsyetimin se i njëjti pasi ishte kthyer nga Shqipëria djali i tij A. nuk ishte në shtëpi dhe të njëjtin sipas tij e kishte udhëzuar që të mos dalë me veturë pa leje dhe të mos i jep përshtypje banorëve të lagjes se po kryen vepra të ndryshme penale, pasi që në fshatin e tij në atë periudhë sipas tij ishin ngritur disa dyshime për vjedhje dhe pas këtyre fjalëve djali nuk është bindur nuk i kishte dëgjuar këshillat dhe udhëzimet tij dhe në ato momente pas qortimit me të është e vërtetë se e kam goditur me një gyp të ujit por që në asnjë mënyrë nuk kam pasur qëllim ti shkaktojë ndonjë lëndim serioz sepse të njëjtin e kam fëmijë, për çka ndien keqardhje për këtë rast. Tutje ka shtuar se sa i përket veprës së dytë penale të armëmbajtjes, sipas tij arma ka qenë e gjyshit të tij të cilën e ka përdorur në luftë dhe e njëjta ka mbetur si kujtim nga lufta e fundit. Andaj i njëjti e lutë gjykatën që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit t'i shqipton një dënim sa më të butë.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari I.S., Prokurori i Shtetit ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit I.S. për veprat penale për të cilat akuzohet, pasi që i njëjti pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit, njëherë i propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

Pasi që gjykata konstatoi që i pandehuri i pranoi në tërësi veprat penale me të cilën është ngarkuar, që i pandehuri i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, që pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, që pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, kryetari i trupit gjykues mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që vlerësoi se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk administroi provat, por vazhdoi me matjen e dënimeve.

Nga thëniet e vet të akuzuarit në shqyrtimin fillestar i cili e pranoi fajësinë u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Po ashtu vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Mendimi i ekspertit mjeko- ligjor Dr. F.B. i datës 03.10.2017 për të dëmtuarin A.S.; Vërtetimi mbi konfiskimin e gjëseneve i datës 07.09.2017 si dhe Foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Gjatë matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i vlerësoj të tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe në lartësinë e dënimit konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Andaj, gjykata si rrethana lehtësuese të akuzuarit i mori faktin e pranimit të fajësisë në shqyrtim fillestar, faktin se ka shpreh keqardhje dhe pendimin e thellë për veprën penale të kryer, i njëjti ka njoftuar gjykatën se me tani të dëmtuarin - djalin e tij ka raporte shumë të mira në relacionin prind – fëmijë dhe me të njëjtin jetojnë në një bashkësi familjare - shtëpi dhe nga ajo periudhë nuk kanë pasur probleme familjare mes veti, ndërsa rrethana rënduese për të akuzuarin gjeti, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, faktin se i pandehuri me veprimet e tij ka përdorur forcën fizike ndaj anëtarit e familjes – djalit të tij, gjithashtu i njëjti pa autorizim ka poseduar mjete të rrezikshme armët me të cilat ka mund të paraqet rrezik fillimisht për anëtarët

e familjes apo edhe për personat tjerë në rrethana të caktuara, kjo është vërtetuar edhe nga vet i pandehuri, andaj gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejt dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit të shkaktuar. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 39 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e një Pushkë M/48. kalibër numër serik 2F5687 prodhim spanjoll, katër fishek me numër serik 2F-5687, 4 copë fishek kalibri nuk dihet, 5 fishek kalibër të ndryshëm, një karikator i zbrazët, një shufër metalike është marrë konform nenit 282 par 1 dhe 2 të KPPK-së, dhe nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil është marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPRK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. nr. 1026/20 të dt. 15.07.2021

Bashkëpunëtoare Profesionale
Bleta Gashi Rrusta

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Avni Syla

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.